

41
11.02.2021

**BORDI I MBIKQYRJES
PUBLIKE**
Nr. 121 Prot.
Datë 11 . 02 . 2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BORDI
I MBIKËQYRJES PUBLIKE**



**INSTITUTI I EKSPERTËVE
KONTABËL TË AUTORIZUAR**

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE
DHE
INSTITUTIT TË EKSPERTËVE KONTABËL TË
AUTORIZUAR**

Tiranë më 19/02/2021

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

dhe

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

Duke parë nevojën për bashkëpunimin, zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve institucionale, shkëmbimin e informacionit dhe mirëkuptimin dypalësh, me qëllim lehtësimin e procedurave të monitorimit në kryerjen e funksioneve të tyre të përcaktuara në ligj

BIEN DAKORT:

Të nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi si më poshtë:

Neni 1 INSTITUCIONET NËNSHKRUESE

Bordi i Mbikëqyrjes Publike (në vijim BMP), është një institucion me statusin e një autoriteti rregullator të pavarur, i cili vepron në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i cili përfaqësohet nga Kryetari, z. Dritan FINO¹;

Dhe

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (në vijim IEKA), është organizata profesionale e audituesve ligjorë ose e thënë ndryshe organizmi profesional, që grupon audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit të cilat ushtrojnë veprimtarinë në Republikën e Shqipërisë, dhe që operon Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", e cila përfaqësohet nga Kryetari i Këshillit Drejtues, z. Berti PASHKO, i zgjedhur kryetar, me anë të Vendimit Nr. 48 datë 09.10.2020² të Këshillit Drejtues të IEKA.

Neni 2 PARIME TË PËRGJITHSHME

Kjo marrëveshje synon, sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit midis dy institucioneve mbi shkallën e zbatimit të standardeve ndërkombëtare të auditimit prej audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, nivelit të kontrollit të cilësisë të punës së tyre si dhe kodit të etikës;

¹ Z. Dritan FINO, është emëruar në cilësinë e Kryetarit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 27, datë 24.03.2017

² Në momentin e nënshkrimit, vendimi Nr. 48 datë 09.10.2020 të Këshillit Drejtues është ende në fazën e shqyrtimit dhe të regjistrimit pranë Regjistratit të Organizatave Jo –Fitimprurëse të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. IEKA, vetë ka paraqitur kërkesën e saj së bashku me dokumentacionin shoqëruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të bërë të mundur regjistrimin e këtij vendimi (Vendimi Nr. 48 datë 09.10.2020 të Këshillit Drejtues të IEKA).

Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi do të realizohen vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat rregullojnë kuadrin ligjor të funksionimit të dy palëve nënshkruese.

Kjo marrëveshje nuk ndryshon ndonjë ligj ose akt nënligjor në fuqi. Gjithashtu nuk ndikon ndonjë marrëveshje tjetër që Bordi i Mbikëqyrjes Publike ose IEKA kanë me institucione të tjera. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të çenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve, që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të së cilit këto institucione janë krijuar dhe funksionojnë.

Institucionet njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit ose bashkëpunimit, në bashkërendim me ligjet respektive ose kërkesat rregullatore.

Shkëmbimi i informacioni mund të mos kryhet nëse:

1. Informacioni i kërkuar është në kundërshtim me ndonjë ligj apo akt që rregullon ruajtjen e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.
2. Informacioni i kërkuar kompromenton proceset hetimore apo gjyqësore.
3. Kërkesa për informacion dhe shkëmbim informacioni, nuk është bërë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë marrëveshje.

Palët marrin përsipër që dhënien e informacionit, ta realizojnë duke e shoqëruar me materialet e duhura dhe të nevojshme shpjeguese.

Neni 3 **QËLLIMI I MARRËVESHJES**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është vendosja e rregullave të bashkëpunimit midis dy institucioneve nënshkruese në mënyrë që të sigurohet:

1. Shkëmbimi i informacionit lidhur me zbatimin e plotë nga ana e audituesve ligjorë, dhe shoqërive të auditimit të kodit të etikës dhe standardeve profesionale siç përcaktohen në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit apo standarde të tjera përkatëse;
2. Ngritja e një grupi pune të përbashkët brenda datës 27 Shkurt 2021, veprimtaria e të cilit do të përfshijë:
 - rishikimin e rregullores nr. 1, datë 26.07.2017 “Për mbledhjen e të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”;
 - rishikimin e rregullores nr. 7, datë 02.10.2018 “Për procedurat dhe metodologjinë e kontrollit të cilësisë së auditimit ligjor”;
 - propozime për ndryshime ligjore;
 - rishikimi i rregulloreve të komitetit të regjistrimit, investigimit dhe disiplinës dhe rregulloret e tjera;
 - bashkërendimi i veprimtarive i cili lidhet me krijimin e praktikave dhe manualeve, përfshirë dhe trajnimet për kualifikimin e vijueshëm;
 - delegimin e Kontrollit të Cilësisë për Njësitë Jo me Interes Publik;
 - dhe harmonizimi me komisionin e investigimit dhe kontrollit të cilësisë;
 - fuqizimin e rolit të IEKAs në proceset e certifikimit dhe regjistrimit të profesionistëve kontabël;
 - bashkërendimin për të hartuar një propozim për Këshillin e Ministrave për rishikimin e klasifikimit të njësive me interes publik;



3
RF

- unifikimin e deklarimeve të misionëve të audituesve ligjorë midis IEKA dhe BMP.
- 3. Tërheqje nga proceset gjyqësore nga IEKA, brenda datës 11 Shkurt, ose nga ana e Bordit nëse ka;
- 4. Ngritja e sistemeve moderne të informacionit dhe dokumentacionit, i cili t'i përgjigjet në kohë sa më të shpejtë dinamikës së misionit publik të Bordit, nëpërmjet marrjes, grumbullimit dhe përpunimit të informacionit, mbi veprimtarinë e audituesve ligjorë, ku ata janë sistematikisht prezent me auditimet, ekspertizat, plan bizneset, opinionet dhe çdo lloj forme tjetër të shërbimeve të tyre, të cilat paraqesin interes dhe impakt në karakterin publik;
- 5. Përmirësimi i nivelit të sigurisë nga auditimet ligjore në kushtet e një mjedisi transparent, të kontrolluar dhe të kujdesshëm, në përputhje të plotë me interesat e publikut, duke respektuar njëkohësisht pavarësinë dhe nderin e anëtarësisë profesionale, si dhe kërkesat për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes të së dhënave personale nga ana e audituesve ligjorë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
- 6. Zbatimi i kodit të etikës së audituesve ligjorë, shoqërive audituese si dhe standardeve të këtij kodi, si dhe standardeve profesionale në zbatim të kërkesave ligjore, subjekt i kontrollit të cilësisë, që realizohet nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
- 7. Zbatimi i kërkesave të legjislacionit dhe standardeve profesionale në fuqi.

Neni 4

KËRKESA PËR BASHKËPUNIM DHE INFORMACION

Kërkesat për informacion ose bashkëpunim bëhen me shkrim, në gjuhën shqipe dhe të plota. Ato duhet t'i drejtohen personit të kontaktit të Institucionit marrës të kërkesës (sipas referencës së Aneksi 1 të kësaj marrëveshje);

Kërkesat për informacion ose bashkëpunim duhet të sigurojnë:

1. Një përshkrim të përgjithshëm lidhur me subjektin për të cilin kërkohet informacion;
2. qëllimin për të cilin i kërkohet informacioni;
3. kohën e dëshiruar për marrjen e përgjigjes;
4. angazhimin e Institucionit kërkues dhe të personelit të tij për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të dhënave personale sipas ligjeve në fuqi.

Institucioni marrës i kërkesës pasi analizon çdo kërkesë për informacion, i siguron Institucionit kërkues informacionin që ai zotëron. Në rast se kërkesa nuk mund të pranohet, Institucioni marrës i kërkesës duhet të japë përgjigjen me shkrim Institucionit kërkues, në lidhje me shkaqet që e pengojnë dhënien e informacionit. Është detyra e Institucionit marrës të kërkesës që të përcaktojë shkallën e konfidencialitetit të informacionit që do të japë.

Neni 5

PËRDORIMI I INFORMACIONIT DHE KONFIDENCIALITETI

Institucioni kërkues do ta përdorë informacionin e marrë vetëm me qëllim të ushtrimit të funksioneve të saj ligjore për qëllimet e përcaktuara në kërkesë ose për qëllime brenda kuadrit të përgjithshëm të përdorimit të shprehura në kërkesë.

Ekzistenca dhe përmbajtja e çdo kërkesë për informacion, e bërë në bazë të kësaj marrëveshjeje, do të trajtohet si konfidenciale nga të dyja institucionet, përveç rastit kur ato bien dakord ndryshe.



Institucioni kërkues i informacionit angazhohet të marrë masat e duhura për mbajtjen e konfidencialitetit si dhe të informojë punonjësit e saj për natyrën konfidenciale të informacionit dhe të përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje. Institucionet nënshkruese duhet të ruajnë informacionin që merr nga institucioni tjetër në përputhje me normën e konfidencialitetit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi si dhe nga pala që ofron informacionin.

Veprimet nga institucionet nënshkruese sipas kësaj marrëveshjeje dhe në mënyrë të veçantë shkëmbimet e informacioneve, duhet të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Çdo informacion i dhënë gjatë procesit të konsultimit duhet të trajtohet si konfidencial.

Institucionet nënshkruese nuk kanë të drejtë të vënë në dispozicion të ndonjë pale të tretë informacionin që kanë marrë sipas kësaj marrëveshjeje, pa marrë më parë miratimin paraprak të institucionit që jep informacionin, përveç rasteve kur kjo kërkohet në bazë të ligjeve që prevalojnë mbi këtë marrëveshje.

Mosrespektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale nga njëra palë, apo përdorimi i informacionit për qëllime të tjera nga ato të paraqitura në kërkesë, i jep të drejtën palës tjetër të ndërpresë menjëherë këtë marrëveshje.

Neni 6 **RISHIKIMI/NDRYSHIMI I MARRËVESHJES**

Palët nënshkruese kanë të drejtë që të rishikojnë kushtet e kësaj marrëveshjeje dhe më pas të bëjnë ndryshimet në formë të shkruar.

Palët nënshkruese bien dakord që ndryshimet që do të propozohen do të kenë synimin e përmirësimit dhe të zgjidhjes së problemeve të ndryshme që mund të dalin përgjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Çdo propozim i IEKA's, nga ana e Bordit do të shqyrtohet me prioritet. Në mënyrë të veçantë e sipas kërkesave, palët mund të kryejnë ndryshime në marrëveshje apo ta deklarojnë atë bashkërisht të përfunduar në rast:

1. Refuzimit apo mosdhënies së përgjigjes brenda afateve të përcaktuara në këtë marrëveshje nga ndonjëri prej palëve për të respektuar dhënien e një informacioni të kërkuar;
2. Ndryshimit të kushteve të tregut apo të aktivitetit mbi auditimin ligjor, ligjeve apo rregulloreve, apo kur del ndonjë vështirësi tjetër e cila e bën të domosdoshëm ndryshimin apo plotësimin e kësaj marrëveshjeje në mënyrë që të realizohen qëllimet e saj.

Palët bien dakord që në rast mosarritje mirëkuptimi, për sa më sipër t'a deklarojnë këtë marrëveshje të zgjidhur dhe pa pasoja për palët. Në një rast të tillë, është e mjaftueshme një shkresë e njëres palë drejtuar palës tjetër duke ia deklaruar të zgjidhur dhe pa efekte ligjore këtë marrëveshje.



Neni 7
TË TJERA

Ngarkohen Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike me strukturat e tyre përbërëse për zbatimin e detyrave të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

Çdo rregullim ose ndryshim sipas nenit 6, në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, mund të kryhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok me shkrim të palëve.

Palët duhet t'i përgjigjen propozimeve reciproke për rregullime ose ndryshime, jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së këtij propozimi.

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të përfundojë me njoftimin me shkrim të secilës palë, një muaj pas këtij njoftimi.

Neni 8
HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të jetë në fuqi për një periudhë kohe të pakufizuar.

Kjo marrëveshje hartohet në katër kopje dhe secila nga palët mban dy kopje në original.

Kjo marrëveshje përbëhet nga 8 (tetë) nene, 6 (gjashtë) faqe.

NËNSHKRUAR sot, më datë 19 / 02 / 2021, në Tiranë.

BORDI
I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Dritan PINO
KRYETAR



INSTITUTI I EKSPERTËVE
KONTABËL TË AUTORIZUAR

Berti PASHKO
KRYETAR

